



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 6 gusht 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi kërkesën për vetëtërheqjen ose heqjen e gjykatësve

Gjykatësve të Trupit Gjykues II:

Gjykatës Çarls Smith III, kryegjykatës

Gjykatës Kristof Bart

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Geinor (gjykatës rezervë)

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit:

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt:

Tobi Kadman

Karl Bakli

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në përputhje me rregullën 20(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Rregullorja” dhe “DHSK”), nenet 36(1), (3) dhe 41 të Udhëzuesit të Punës së Zyrës Administrative mbi Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës”), nxjerr këtë vendim mbi kërkesën e z. Nasim Haradinaj dhe bashkimin me këtë kërkesë të z. Hysni Gucati për vetëtërheqjen ose heqjen e Kryetares, nënkryetarit dhe kryegjykatësit (“Kërkesa”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 15 korrik 2021, Kryetarja caktoi Trupin Gjykses II në procesin gjyqësor kundër të akuzuarve,² pas njoftimit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake sipas rregullës 98(3) të Rregullores, se dosja e plotë e çështjes ishte gati për t’iu kaluar trupit gjykses.³

2. Më 26 korrik 2021, Mbrojtja e z. Haradinaj dorëzoi një kërkesë, së cilës më 28 korrik 2021⁴ iu bashkua edhe Mbrojtja e z. Gucati.

II. DISKUTIM

3. Kryetarja vëren se kur dorëzohet një kërkesë për vetëtërheqje ose heqje të një

¹ F00268/RED, Version i redaktuar publik i kërkesës për vetëtërheqje të Kryetares së Dhomave të Specializuara, gjykatëses Ekaterina Trendafilova dhe nënkryetarit të Dhomave të Specializuara, gjykatësit Çarls L. Smith, kryegjykatës i Trupit Gjykses II, 28 korrik 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 26 korrik 2021) (publik me shtojca konfidenciale); F00269, Bashkim me kërkesën për vetëtërheqje KSC-BC-2020-07/F00268, 28 korrik 2021 (konfidencial) (“Bashkimi me kërkesën”). Mbrojtja e z. Haradinaj dorëzoi një version tjetër të korrigjuar të kërkesës në të njëjtën ditë. Shih F00268/COR, Kërkesë për vetëtërheqje të Kryetares së Dhomave të Specializuara, gjykatëses Ekaterina Trendafilova dhe të nënkryetarit të Dhomave të Specializuara, gjykatësit Çarls L. Smith, kryegjykatës i Trupit Gjykses II, 28 korrik 2021 (konfidenciale, me shtojca konfidenciale). Duke pasur parasysh korrigjimet shumë të vogla që iu bënë kërkesës, të gjitha referencat në këtë vendim janë në lidhje me versionin e redaktuar publik të kërkesës, dorëzuar më 28 korrik 2021.

² F000263, Vendim për caktimin e Trupit Gjykses II, 15 korrik 2021.

³ Shih F00261, Njoftim në përputhje me rregullën 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, 14 korrik 2021.

⁴ Bashkimi me kërkesën, para. 1.

gjykatësi, përgjithësisht pranohet se gjykatësi në fjalë nuk mund të gjykojë në një çështje objekt i së cilës është vetë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh rrethanat në të cilat bazohet kjo kërkesë dhe siç do të shtjellohet më poshtë, Kryetarja ka kompetencën për të vendosur vetë për këtë çështje.⁵

A. Çështje paraprake – numri i lejuar i fjalëve dhe dorëzimi brenda afatit i kërkesës

4. Së pari, Kryetarja vëren se ajo zbaton *mutatis mutandis* dispozitat e Udhëzuesit të Punës. Për sa i takon kërkesës, Kryetarja vë në dukje se ajo përmban 9.779 fjalë dhe rrjedhimisht tejkalon me gati 40% numrin e lejuar prej 6.000 fjalësh të përcaktuar në nenin 41 të Udhëzuesit të Punës. Mbrojtja e z. Haradinaj nuk ka kërkuar ndryshim të numrit të lejuar të fjalëve brenda një kohe të mjaftueshme paraprakisht, as nuk ka dhënë ndonjë shpjegim nëse kishte arsye të vlefshme për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve, siç përcaktohet në nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës.

5. Pavarësisht nga konstatimi i mësipërm, në mënyrë që kjo kërkesë të trajtohet në kohë, Kryetarja përfiton nga mundësia që ofron neni 36(3) i Udhëzuesit të Punës dhe, duke bërë një përjashtim, e konsideron kërkesën si “të vlefshme”. Megjithatë, Mbrojtjes së Haradinajt i sillet në vëmendje që të tregojë kujdesin e duhur në parashtrimet e ardhshme.⁶

6. Më tej, në lidhje me kohën e parashtrimit të kërkesës, rregulla 20(3) e Rregullores përcakton shumë qartë se “një palë mund t’i paraqesë kërkesë Kryetarit [...] menjëherë, por jo më vonë se dhjetë (10) ditë pasi pala në fjalë të ketë marrë dijeni për arsyet mbi të cilat mbështetet kërkesa” (theksimi i shtuar).⁷ Fjala “menjëherë” do të thotë “në

⁵ Shih më sipër, para. 19-22, 36.

⁶ Shih po kështu IA004/F00007, Vendim mbi apelet e Mbrojtjes kundër vendimit mbi mocionet paraprake, 23 qershor 2021, para. 17.

⁷ Rregulla 20(3) e Rregullores thotë: “Një palë mund t’i paraqesë Kryetarit kërkesë për heqjen e një gjykatësi menjëherë, por jo më vonë se dhjetë (10) ditë pasi pala në fjalë të ketë marrë dijeni për arsyet mbi të cilat mbështetet kërkesën për heqjen e atij gjykatësi. Gjykatësi në lidhje me të cilin është paraqitur kërkesë për heqje, mund të vetëdërgohet, pasi të jetë informuar për kërkesën e lartpërmendur.”

mënyrë të menjëhershme”,⁸ “aty për aty”,⁹ ose “pa interval kohe”.¹⁰ Në mënyrë të ngjashme, fjala “arsye” i referohet “bazës ose themelit”, “arsyeve të mjaftueshme që sipas ligjit përligjin masën ndreqëse”.¹¹ Rrjedhimisht, përmendja e fjalës “menjëherë” e ndjekur nga fjalët “por jo më vonë se dhjetë (10) ditë” thekson se pala e interesuar, në këtë rast Mbrojtja, vepron menjëherë sapo merr dijeni për arsyet që përbëjnë bazën e kërkesës, qoftë përmes një burimi publik ose në ndonjë mënyrë tjetër, por jo më vonë se dhjetë (10) ditë më pas. Afati dhjetëditor tregon afatin maksimal brenda të cilit pala mund të dorëzojë kërkesën në përputhje me rregullën 20 të Rregullores.

7. Në kërkesë kërkohet vetëtërheqja ose heqja nga kjo çështje gjyqësore e Kryetares dhe nënkryetarit, ndonëse për arsye të ndryshme. Rrjedhimisht, koha e dorëzimit të kërkesës do të trajtohet veçmas për Kryetaren dhe nënkryetarin.

8. Në lidhje me nënkryetarin, i cili është kryegjykatës në çështjen gjyqësore në fjalë, Kryetarja vëren se kërkesa u dorëzua brenda 10 ditësh pas njoftimit të vendimit për caktimin e Trupit Gjyqësor II dhe, për këtë arsye, është brenda afatit të përcaktuar në rregullën 20(3) të Rregullores. Rrjedhimisht, në këtë aspekt, Kryetarja gjykon se kërkesa është dorëzuar në kohë.

9. Duke iu kthyer kohës së dorëzimit të kërkesës për Kryetaren, pas shqyrtimit të kërkesës dhe shtojcave të saj, Kryetarja gjykon se argumentet e Mbrojtjes përqendrohen kryesisht tek takimi informues diplomatik i datës 8 dhjetor 2020. Mbrojtja i referohet gjithashtu takimit informues diplomatik të datës 11 shkurt 2021.¹²

⁸ Fjalori *Webster's New World College Dictionary*, botimi i katërt, 2010, gjendet në internet në adresën: [Immediately definition and meaning | Collins English Dictionary \(collinsdictionary.com\)](https://www.collinsdictionary.com/en/english-american/definition-and-meaning-of/immediately), parë më 30/07/2021.

⁹ Fjalori *Collins English Dictionary*, gjendet në internet në adresën: [Immediately definition and meaning | Collins English Dictionary \(collinsdictionary.com\)](https://www.collinsdictionary.com/en/english-american/definition-and-meaning-of/immediately), parë më 30/07/2021.

¹⁰ Fjalori *Merriam Webster Dictionary*, të gjendet në internet në adresën: [Immediately | Definition of Immediately by Merriam-Webster](https://www.merriam-webster.com/dictionary/immediately), parë më 30/07/2021.

¹¹ Fjalori *The Free Dictionary*, gjendet në internet në adresën: [Grounds legal definition of Grounds \(thefreedictionary.com\)](https://www.thefreedictionary.com/grounds).

¹² Shih Kërkesa, para. 41-42; Shtojca A04.

Takimi i parë informues diplomatik u mbajt pothuajse tetë muaj para datës së dorëzimit të kërkesës, ndërsa takimi i fundit u zhvillua më shumë se pesë muaj para asaj date. Gjithashtu, dokumentacioni i çështjes gjyqësore tregon qartë se Mbrojtja i shprehu shqetësimet e saj në lidhje me takimet informuese diplomatike të 8 dhjetorit 2020 dhe 11 shkurtit 2021 në parashtrimet e saj të mëhershme para Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe kishte dijeni të plotë për çështjet kryesore që donte të parashtronte.

10. Për shembull, që më 3 mars 2021, në një kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së ZPS-së lidhur me një kërkesë që kishte të bënte me takimet informuese diplomatike, Mbrojtja e z. Haradinaj deklaroi se ai “ka dhënë informacione të pakontestueshme në lidhje me takimin [e datës 11 shkurt 2021], të cilat ngrenë disa shqetësime serioze”.¹³ Si rrjedhim, duke qenë se në fillim të marsit 2021 Mbrojtja ka pasur “informacione të pakontestueshme”, ajo ishte në zotërim të informacioneve që i mundësonin ta dorëzonte kërkesën shumë më herët. Në fakt, në paragrafin 41 të kërkesës, Mbrojtja pranon se hollësitë e takimit informues diplomatik të datës 11 shkurt 2021 “u publikuan nga mediat” më 15 shkurt 2021.¹⁴ Kjo do të thotë që Mbrojtja kishte informacion të mjaftueshëm në atë kohë për të dorëzuar kërkesën.

11. Gjithashtu, pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake të datës 11 mars 2021 për refuzimin e kërkesës së z. Haradinaj për nxjerrje të materialeve në lidhje me takimin informues diplomatik,¹⁵ dhe refuzimit të kërkesave për leje për apelim të

¹³ F00146, Kundërpërgjigja e Mbrojtjes së Haradinajt ndaj përgjigjes së Prokurorisë mbi kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për informacion në lidhje me takimet informuese diplomatike, 3 mars 2021, para. 7

¹⁴ Kërkesa, para. 41; F00138, Parashtrime të Mbrojtjes pas urdhrorit për caktimin e datës së konferencës së dytë mbi ecurinë e çështjes dhe çështje të lidhura me të (KSC-BC-2020-07/F00129), 23 shkurt 2021 (“Parashtrime të Mbrojtjes në lidhje me konferencën e dytë mbi ecurinë e çështjes”), para. 43-44.

¹⁵ F00150, Vendim mbi kërkesën për informacion mbi takimin informues diplomatik, 11 mars 2021 (“Vendimi lidhur me takimin informues diplomatik”), para. 18.

vendimit,¹⁶ për Mbrojtjen u bë e qartë se në këtë drejtim nuk mund të merrej asnjë informacion i mëtejshëm. Nga kjo rrjedh se Mbrojtja e z. Haradinaj mund të kishte dorëzuar kërkesë mbi bazën e informacionit që kishte në dispozicion në atë kohë, pasi Mbrojtja ishte në dijeni të rrethanave në të cilat mbështetej kërkesa shumë kohë përpara datës së dorëzimit të saj.

12. Duke iu referuar një kërkesë “*inter partes*” për informacion drejtuar ZPS-së në lidhje me takimin informues diplomatik të datës 8 dhjetor 2020, Mbrojtja më tej argumenton se më 26 korrik 2021¹⁷ ZPS-ja e refuzoi kërkesën. Sipas Mbrojtjes, kërkesa “po bëhet tani bazuar në faktin se informacioni për ato takime informuese diplomatike i është dhënë Mbrojtjes kohët e fundit në mënyrë konfidenciale, dhe përmbajtja e tij është verifikuar”.¹⁸ Megjithatë, Mbrojtja nuk shpjegon arsyen pse kërkesën “*inter partes*” në lidhje me takimin informues diplomatik të 8 dhjetorit 2020 ia dorëzoi ZPS-së *vetëm* më 19 korrik 2021, ndonëse kishte dijeni për të shumë kohë përpara asaj date.

13. Mbrojtja nuk shpjegon as se çfarë lidhje ka vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake për kalimin e dosjes së çështjes Trupit Gjykues II ose vendimi për njoftimin e zgjedhjes së kryegjykatësit, me çështjen e heqjes së Kryetares për shkak të takimit informues diplomatik të 8 dhjetorit 2020, dhe çfarë lidhje kanë këto dy vendime me dorëzimin me vonesë të kërkesës.

14. Në mungesë të faktimit të duhur të këtyre pikave që kanë të bëjnë me dorëzimin me vonesë të kërkesës, kjo e fundit mund të konsiderohet se është paraqitur jashtë afatit. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin që gjatë procesit Mbrojtja u orvat disa herë të siguronte nxjerrjen e një informacioni më të hollësishëm, të cilin ata e

¹⁶ F00178, Vendim mbi kërkesat e Mbrojtjes për leje për apelim të vendimit mbi kërkesën për informacion lidhur me takimin informues diplomatik (“Vendimi mbi kërkesat për leje për apel”), 9 prill 2021, para. 30.

¹⁷ Kërkesa, para. 23.

¹⁸ Kërkesa, para. 24.

konsideronin të rëndësishëm për pretendimet e tyre,¹⁹ Kryetarja gjykon se është në interes të drejtësisë të shqyrtohet themelësia e kërkesës.

B. Vetëtërheqja ose heqja e Kryetares

15. Mbrojtja parashtrohet se pjesëmarrja dhe deklaratat e bëra në takimin informues diplomatik të datës 8 dhjetor 2020 minojnë “vendimmarrjen e pavarur dhe të paanshme gjyqësore të Kryetares dhe përfaqësimin e Dhomave të Specializuara [...] dhe dëmtojnë rëndë administrimin e duhur të drejtësisë para Dhomave të Specializuara ose funksionimin e duhur të brendshëm të Dhomave të Specializuara dhe se “veprimet e Kryetares mund të dëmtojnë statusin e Dhomave të Specializuara”.²⁰

16. Mbrojtja pretendon se “të drejtat dhe interesat e tyre cenohen ndjeshëm” nga “prania e Kryetares në cilësinë e saj përfaqësuese si dhe në cilësinë e saj gjyqësore” dhe thekson se ekziston “rreziku i shpërdorimit të pozitës zyrtare, i përkrahimit të shtrembëruar të pandehurve dhe përkrahjes së kauzës së një pale tjetër” nëse Kryetarja vazhdon të ushtrojë funksionet e saj gjyqësore, administrative, ose të administrimit të lëndës në këtë çështje.²¹ Mbrojtja pretendon se, për arsyet e parashtuara në kërkesë, çdo “vëzhgues objektiv ose person i paanshëm” do të “perceptonte ekzistencën e anshmërisë ose parregullsisë gjyqësore dhe një mungesë të qartë të paanshmërisë dhe pavarësisë, që nuk mund të rivendoset”.²²

17. Rrjedhimisht, Mbrojtja kërkon që:²³

- a. Kryetarja të vetëtërhiqet ose të hiqet nga ushtrimi i çdo funksioni gjyqësor, administrativ ose për administrimin e lëndës në këtë çështje gjyqësore, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, caktimin e gjykatësve në panele, pjesëmarrjen si anëtare në një panel të apelit ose marrjen e

¹⁹ Parashtrime të Mbrojtjes në lidhje me konferencën e dytë mbi ecurinë e çështjes, para. 45; Vendimi lidhur me takimin informues diplomatik; Vendimi mbi kërkesat për leje për apel.

²⁰ Kërkesa, para. 1. Shih gjithashtu, Kërkesa, para. 32-50, 56-61, 68-69.

²¹ Kërkesa, para. 2. Shih gjithashtu, Kërkesa, para. 51-55.

²² Kërkesa, para. 32. Shih gjithashtu, Kërkesa, para. 62-67.

²³ Kërkesa, para. 101(a).

vendimeve në lidhje me kërkesën për vetëtërheqjen e nënkryetarit në përputhje me Rregulloren.

18. Së pari, Kryetarja do të trajtojë kërkesën e Mbrojtjes për vetëtërheqje ose heqje nga ushtrimi i çdo funksioni “administrativ ose i administrimit të lëndës në këtë çështje gjyqësore”. Argumentet e Mbrojtjes që shërbejnë si bazë për kërkesën që Kryetarja, ndër të tjera, të vetëtërhiqet, përqendrohen kryesisht në pretendimet lidhur me takimet me komunitetin diplomatik në të cilat ka marrë pjesë Kryetarja.²⁴

19. Ndonëse është e natyrshme Kryetarja mund të konsiderojë mundësinë e vetëtërheqjes nëse e gjykon këtë të nevojshme, nuk mund të ketë vetëtërheqje ose heqje të Kryetares në bazë të rregullës 20(1) të Rregullores për arsyet që shtjellohen më hollësisht në vijim.²⁵

20. Neni 4(3) i Ligjit parashikon që Kryetari mund të përfaqësojë organin dhe subjektin e tij përkatës për ushtrimin ose përmbushjen e funksioneve të veta. Ndër këto funksione përfshihen takimet vjetore me shtetet që financojnë ose kontribuojnë me burime të tjera për DHSK-në dhe me aktorë të tjerë, gjatë të cilave mund të bëhen raportime të përditësuara mbi përparimin e bërë nga DHSK-ja në përmbushjen e mandatit të saj.²⁶ Në këtë aspekt, parashtrimet e Mbrojtjes bazohen tërësisht në keqinterpretimin e komenteve të bëra gjatë një takimi të zakonshëm informues diplomatik dhe janë nxjerrë nga shënimet në formë të përmbledhur të një burimi të paidentifikuar. Për këtë arsye, Kryetarja refuzon të vetëtërhiqet, siç kërkon Mbrojtja me argumentet e saj, nga ushtrimi i funksioneve administrative në këtë çështje, të cilat ia ngarkon korniza ligjore e DHSK-së.

21. Në lidhje me kërkesën për heqje nga ushtrimi i të njëjtave përgjegjësi (ushtrimi

²⁴ Shih, p.sh., Kërkesa, para. 1-2, 31-50.

²⁵ Shih më lart, para. 21-22.

²⁶ DHSK-ja ka raportuar vazhdimisht për këto takime në raportet vjetore publike, që mund të gjenden në faqen e saj të internetit në <https://www.scp-ks.org/en/publications/reports>. Shih për shembull KSC/SPO Raporti vjetor për vitin 2020, f. 7, 30, 33; KSC/SPO Raporti vjetor për vitin 2019, f. 9, 31; KSC/SPO raporti vjetor për vitin 2018, f. 8, 22-23; KSC/SPO Raporti i parë, f. 7, 26.

i çdo funksioni “administrativ ose i administrimit të lëndës në këtë çështje gjyqësore”), Kryetarja vëren se neni 32(3) i Ligjit i ngarkon shprehimisht vetëm Kryetares përgjegjësinë “për administrimin gjyqësor” të DHSK-së. Këtu përfshihet nxjerrja e vendimeve për caktimin e gjykatësve në përputhje me nenin 33 të Ligjit, si dhe të gjitha funksionet e tjera që kanë të bëjnë me administrimin gjyqësor të DHSK-së.

22. Duhet të kujtojmë se rregulla 20 e Rregullores kufizohet në heqjen e një gjykatësi që merr pjesë në gjykimin e një çështjeje gjyqësore, i cili do të vendosë mbi pafajësinë ose fajësinë e një të akuzuari.²⁷ Kjo del nga formulimi i qartë i rregullës në fjalë, që nuk parashikon heqje të ndokujt tjetër - siç është rasti i Kryetares që ushtron funksionet e saj administrative²⁸ - përveç të gjykatësve që marrin pjesë në gjykimin e çështjeve gjyqësore. Me fjalë të tjera, as Ligji dhe as Rregullorja nuk parashikojnë heqjen, në bazë të kërkesës së një pale, të Kryetares që ushtron kompetencat e saj administrative, e aq më pak ndalimin e nxjerrjes së vendimeve ose urdhrave të ardhshëm administrativë.²⁹ Rrjedhimisht, kërkesa e Mbrojtjes për heqjen e saj si Kryetare nga ushtrimi i funksioneve të ardhshme administrative në këtë çështje gjyqësore, hidhet poshtë.

²⁷ Shih rregulla 20(1) e Rregullores.

²⁸ Shih, p.sh., IRMCT/MPNTP, *Prosecutor v. Radovan Karadžić*, Case No. MICT-13-55-A, Decision on Prosecution Motion to Strike Karadžić’s Second Motion to Disqualify Judge Theodor Meron, Motion to Disqualify Judge William Sekule, and for Related Orders, 1 nëntor 2018 (“*Karadžić Decision*”), para. 13 (“urdhri që përcakton përbërjen e Dhomës së Apelit në një çështje të veçantë nxirret nga Kryetari, në bazë të kompetencës së tij për të koordinuar punën e Dhomave, dhe, për këtë arsye, kjo është një çështje administrative. Duke pasur parasysh që rregulla 18(A) nuk trajton përfshirjen e një gjykatësi në çështjet administrative, Kryetari nuk mund të hiqet nga ushtrimi i funksionit të caktimit të anëtarëve të panelit të Dhomës së Apelit. Rrjedhimisht, nëse parashtruesi i kërkesës kërkon heqjen e Kryetarit nga ushtrimi i funksioneve administrative që kanë të bëjnë me çështjen gjyqësore të atij parashtruesi, një kërkesë e tillë nuk ka bazë ligjore në Rregullore”). *Lukić Decision*, pp. 1-2; ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Momčilo Krajišnik*, Case No. IT-00-39-A, Decision on Prosecution Request for Clarification of President’s Order of 16 May 2007, 28 qershor 2007, para. 2 (“Statuti dhe Rregullorja i japin qartë vetëm Kryetarit kompetencën për të koordinuar punën e Dhomave dhe për të përcaktuar përbërjen e Dhomës së Apelit dhe të dhomave gjyqësore [...]. E drejta e Kryetarit për të marrë këto vendime dhe për të nxjerrë urdhra të tillë buron drejtpërdrejt nga kompetencat ekzekutive të Kryetarit [...] dhe ushtrimi i këtyre kompetencave nuk mund të paraqitet për gjykim nga palët.”).

²⁹ Shih. *Karadžić Decision*, para. 14.

23. Kryetarja në vijim do të trajtojë kërkesën e Mbrojtjes për vetëtërheqje ose heqje nga ushtrimi i çdo funksioni gjyqësor. Në këtë aspekt, Kryetarja aktualisht nuk kryen asnjë funksion gjyqësor në këtë çështje. Rrjedhimisht, ajo as nuk mund të vetëtërhiqet e as të hiqet aktualisht nga ushtrimi i funksioneve gjyqësore, siç parashikohet në rregullën 20(1) të Rregullores.³⁰ Rrjedhimisht, kërkesa e Mbrojtjes në lidhje me këtë pikë, hidhet poshtë.

C. Vetëtërheqja ose heqja e nënkryetarit dhe gjykatësit të Trupit Gjykoës II

24. Mbrojtja parashtron në mënyrë të përgjithshme se pretendimet e shprehura nga një individ në lidhje me kohën kur gjykatësi Smith ishte Kryetar i Asamblesë së Gjykatësve të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë ("EULEX"), "minojnë vendimmarrjen e tij gjyqësore dhe rrezikojnë të dëmtojnë rëndë administrimin e duhur të drejtësisë para DHSK-së, ose funksionimin e duhur të brendshëm të DHSK-së dhe gjithashtu se veprimet e nënkryetarit Smith mund të kenë dëmtuar statusin e DHSK-së".³¹

25. Mbrojtja parashtron se "këto rrethana të mëhershme të pretenduara, do të bënin që çdo vëzhgues objektiv ose person i paanshëm të perceptonte ekzistencën e anshmërisë ose parregullsisë gjyqësore si dhe një mungesë të qartë të paanshmërisë dhe pavarësisë që nuk mund të rivendoset".³² Gjithashtu, Mbrojtja parashtron, siç duket për shkak të postit që ky gjykatës mban si nënkryetar, se kur një kërkesë për heqje ka të bëjë si me Kryetaren ashtu edhe me nënkryetarin, "nuk do të ishte e përshtatshme për asnjërin prej tyre që ankesa e paraqitur kundër njërit të gjykohej nga

³⁰ Shih TPNJ, *Prosecutor v. Milan Lukić & Sredoje Lukić*, Case No. IT-98-32/1-AE11bis.1, Decision on 'Motion to Disqualify President and Vice-President from Appointing Appeals Chamber and to Disqualify President Judge and Judge Meron from Sitting on Appeals Chamber', 4 maj 2007 ("Lukić Decision"), p. 1.

³¹ Kërkesa, para. 3. Shih gjithashtu, Kërkesa, para. 72, 75-76, 94-95.

³² Kërkesa, para. 5. Shih gjithashtu, Kërkesa, para. 85, 88.

tjetri”.³³

26. Ndonëse në kërkesën e saj Mbrojtja nuk bën dallim të qartë midis rolit të tij si nënkryetar dhe rolit si gjykatës i Trupit Gjykses II,³⁴ Kryetarja do ta trajtojë atë si kërkesë për vetëtërheqjen dhe/ose heqjen e tij nga të dy rolet. Kryetarja fillimisht do të trajtojë parashtrimet e Mbrojtjes, të cilat duket se kanë lidhje me postin e gjykatësit si nënkryetar.

a. Kërkesa për vetëtërheqje ose heqje të nënkryetarit

27. Mbrojtja kërkon që “nënkryetari të vetëtërhiqet ose të hiqet nga ushtrimi i çdo funksioni gjyqësor, administrativ ose i administrimit të lëndës në këtë çështje gjyqësore”.³⁵

28. Neni 32(4) i Ligjit parashikon që nënkryetari aktivizohet nga regjistri i gjykatësve ndërkombëtarë dhe merr përsipër detyrat e Kryetarit të DHSK-së “në mungesë të këtij të fundit apo nga pamundësia e tij për të vepruar”. Siç u konstatua më lart, Kryetarja nuk mund të hiqet nga ushtrimi i funksioneve të saj administrative në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren dhe ajo as nuk mungon, e as nuk e ka të pamundur të veprojë. Rrjedhimisht, në këtë çështje gjyqësore, nuk krijohen rrethana që nënkryetari të ushtrojë funksionet e Kryetares, siç parashikohet në nenin 32(4) të Ligjit. Për këtë arsye, kërkesa e Mbrojtjes për heqjen e nënkryetarit hidhet poshtë si kërkesë pa objekt shqyrtimi.

³³ Kërkesa, para. 17. Shih gjithashtu, Kërkesa, para. 70.

³⁴ *Krahaso*, për shembull, Kërkesa, para. 3 (ku trajtohet vetëtërheqja e “nënkryetarit Smith nga Trupi Gjykses II”), 4 (ku trajtohet “nënkryetari Smith si kryegjykatës i Trupit Gjykses II” dhe “vazhdimi prej nënkryetarit i shërbimit si kryegjykatës i Trupit Gjykses II nëse ai nuk vetëtërhiqet ose hiqet”), 5 (ku kërkohet vetëtërheqja ose heqja e “nënkryetarit nga të gjitha funksionet gjyqësore, administrative dhe të administrimit të lëndës në këtë çështje gjyqësore”), 6 (ku kërkohet caktimi i një paneli të përbërë nga tre gjykatës për të “përcaktuar nëse nënkryetari duhet të vetëtërhiqet nga detyra e kryegjykatësit ose e gjykatësit të Trupit Gjykses II), *me* para. 17 (ku Mbrojtja trajton “vetëtërheqjen e Kryetares dhe nënkryetarit” në të njëjtën çështje gjyqësore dhe i referohet “një ankese të bërë kundër Kryetares dhe nënkryetarit në detyrë”).

³⁵ Kërkesa, para. 101(b). Shih gjithashtu, kërkesa, para. 5.

b. Kërkesa për vetëtërheqje ose heqje të gjykatësit Smith

29. Edhe pse masa ndreqëse e kërkuar nuk e thotë shprehimisht këtë, Kryetarja tani do të trajtojë kërkesën e Mbrojtjes për vetëtërheqjen dhe/ose heqjen e gjykatësit si anëtar i Trupit Gjykses II dhe, rrjedhimisht, për ndryshime në përbërjen e Trupit Gjykses II. Për këtë qëllim, Mbrojtja mbështetet në deklaratat e bëra nga një ish-gjykatës i EULEX-it në lidhje me gjykatësin Smith kur ai ishte Kryetar i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it.³⁶ Mbi këtë bazë, Mbrojtja kërkon që:³⁷

- c. të caktohet një panel i përbërë prej tre gjykatësish, në përputhje me rregullën 20(3) të Rregullores, për marrjen e vendimit mbi këtë kërkesë, mbi bazën se, për arsyet e përcaktuara në kërkesë, Kryetarja nuk mund të gjykojë mbi një ankesë të bërë ndaj nënkryetarit dhe ky i fundit nuk mund të gjykojë mbi një ankesë të bërë ndaj Kryetares;
- d. gjykatësi Fergal Geinor, i caktuar si gjykatës rezervë, të caktohet si anëtar i Trupit Gjykses II;
- e. të caktohet një gjykatës tjetër rezervë për Trupin Gjykses II;
- f. të caktohet një kryegjykatës tjetër për Trupin Gjykses II.

30. Duke trajtuar së pari kërkesën për vetëtërheqje, Kryetarja vëren se gjykatësi Smith u njoftua për kërkesën dhe ka bërë të ditur se nuk ka ndërmend të vetëtërhiqet nga kjo çështje gjyqësore. Rrjedhimisht, Kryetarja do të trajtojë kërkesën për heqje, sipas rregullës 20(3) të Rregullores.

31. Fillimisht, Kryetarja rikujton parimet e përgjithshme që udhëheqin procedurën e heqjes së gjykatësve. Siç është konstatuar vazhdimisht nga institucione të ndryshme ndërkombëtare dhe institucione të tjera gjyqësore që zbatojnë të njëjtat standarde, perceptimi i papranueshëm i anshmërisë ekziston në ato raste kur rrethanat do të bënin që një vëzhgues objektiv dhe i informuar si duhet, të perceptonte në mënyrë të arsyeshme se ka anshmëri.³⁸ Për çdo gjykatës merret si i mirëqenë një supozim i fortë

³⁶ Shih Kërkesa, para. 71, 73-84, 86-87, 89-93, 96-100. Shih gjithashtu, Shtojcat A06-A07. Gjithashtu, Mbrojtja i referohet një shkëmbimi përmes postës elektronike mes një ish-gjykatësi të EULEX-it dhe gjykatësit Smith (Shtojca A08), si dhe dy mesazheve përmes postës elektronike nga ish-gjykatës të tjerë të EULEX-it lidhur me veprimet që pretendohet se ka kryer gjykatësi Smith (Shtojca A09).

³⁷ Kërkesa, para. 101(c)-(d).

³⁸ Shih, p.sh., STL/TSL, *The Prosecutor v. Salim Jamil Ayyash*, Case No. STL-11-01/A-1/OTH/R25, Decision on Ayyash Defence Application for the Disqualification of Judge Riachy, 3 shkurt 2021 ("*Ayyash*

për paanshmëri, i cili nuk mund të hidhet poshtë aq lehtë.³⁹ I takon palës që pretendon se ka anshmëri që të paraqesë prova të besueshme dhe të mjaftueshme për ta hedhur poshtë këtë supozim, sepse asnjë gjykatës nuk mund të hiqet nga gjykimi i një çështjeje mbi bazën e pretendimeve të përgjithshme ose abstrakte të cilat nuk janë as të faktuara e as të hollësishme.⁴⁰

32. Ky standard i lartë kërkohet sepse “ashtu sikurse çdo perceptim real për anshmërinë e një gjykatësi dëmton besimin në administrimin e drejtësisë, do të ishte po aq një kërcënim i mundshëm ndaj interesave të administrimit të paanshëm dhe të drejtë të drejtësisë nëse gjykatësit do të hiqeshin nga gjykimi i çështjeve për shkak të pretendimeve të pabazuara dhe të pambështetura me prova për perceptim të anshmërisë”.⁴¹ Në fakt, nëse do të konstatohej ndryshe, do të cenohej aftësia e gjykatësve për të kryer detyrat e tyre në përputhje me mandatin e organit gjyqësor

Decision”), para. 7; MPNTP, *Prosecutor v. Milan Lukić*, Case No. MICT-13-52-R.1, Decision on Request for Disqualification, 28 tetor 2020 (“*Lukić Decision*”), para. 11; TPNJ, *Prosecutor v. Mićo Stanišić and Stojan Župljanin*, Case No. IT-08-91-A, Judgement, 30 qershor 2016 (“*Stanišić and Župljanin Appeal Judgement*”), para. 43; TPNJ, *Prosecutor v. Nikola Šainović et al.*, Case No. IT-05-87-A, Judgement, 23 janar 2014, para. 180; TPNJ, *Prosecutor v. Anto Furundžija*, Case No. IT-95-1711-A, Judgement, 21 korrik 2000, para. 189. Shih gjithashtu GJPN, *The Prosecutor v. Al Hassan Ag Abdoul Aziz Ag Mohamed Ag Mahmoud*, Case No. ICC-01/12-01/18-398-AnxI, 8 korrik 2019 (“*Hassan Decision*”), para. 20; KEDNJ, *Case of Nicholas v. Cyprus*, Application No. 63246/10, Judgment, 9 prill 2018 (“*Nicholas Judgment*”), para. 54 (dhe jurisprudencën e cituar po aty).

³⁹ Shih, p.sh., *Ayyash Decision*, para. 8; *Lukić Decision*, para. 11; ECCC, Case No. 002/31-10-2019-ECCC/SC (03), Decision on Khieu Samphân’s Application for Disqualification of Six Appeal Judges who Adjudicated in Case 002/01, 14 korrik 2020 (“*Samphân Decision*”), para. 64; *Hassan Decision*, paras 19, 21; *Stanišić and Župljanin Appeal Judgement*, para. 44; GJPN, *The Prosecutor v. Thomas Lubanga Dyilo*, Annex I, Case No. ICC-01/04-01/06-3154-AnxI, 3 gusht 2015, para. 35. Shih gjithashtu *Nicholas Judgment*, para. 50; KEDNJ, *Case of Micallef v. Malta*, Application No. 17056/06, Judgment, 15 tetor 2009, para. 94; KEDNJ, *Case of Indra v. Slovakia*, Application No. 46845/99, Judgment, 1 shkurt 2005, para. 49.

⁴⁰ *Ayyash Decision*, para. 8; *Samphân Decision*, para. 64; *Lukić Decision*, para. 11; *Stanišić and Župljanin Appeal Judgement*, para. 44. Gjithashtu, perceptimi i anshmërisë ka të bëjë me çështje të veçanta. Një konstatim mbi perceptim të anshmërisë në një çështje nuk do të thotë heqje automatike e një gjykatësi nga gjykimi i çështjeve të tjera. Duhet të provohet se veprimet e mëparshme të gjykatësit, të cilat pretendohet se krijojnë perceptim të papranueshëm të anshmërisë, kanë ndikuar në paanshmërinë e tij ose të saj në gjykimin e çështjes në shqyrtim. Shih TPNJ, *Prosecutor v. Mićo Stanišić et al.*, Case No. IT-08-91-A, Judgment, 30 qershor 2016, para. 32-33.

⁴¹ TPNJ, *Prosecutor v. Zejnil Delalić et al.*, Case No. IT-96-21-A, Judgment, 20 shkurt 2001, para. 707. Shih gjithashtu *Samphân Decision*, para. 64; TPNJ, *Prosecutor v. Ratko Mladić*, Case Nos. IT-09-92-AR73.6 & IT-09-92-AR73.7, Decision on Ratko Mladić’s Motion for Disqualification of Judge Fausto Pocar, 26 tetor 2016, para. 11.

përkatës, përfshirë edhe DHSK-në, dhe kjo do të kishte një ndikim shumë negativ në administrimin e drejtësisë.

33. Parimet e mësipërme pasqyrohen në kornizën ligjore të DHSK-së, përfshirë në rregullën 20(3) të Rregullores, e cila parashikon hedhjen poshtë me procedurë të shkurtuar të një kërkesë për heqjen e një gjykatësi që merr pjesë në një çështje gjyqësore nëse Kryetari gjykon se një kërkesë e tillë është “qëllimkeqe, e gabuar, e pavlerë apo e pabazë”.

34. Pasi ka shqyrtuar kërkesën, Kryetarja vëren se parashtrimet e Mbrojtjes paraqesin pretendime të pabaza⁴² në lidhje me gjykatësin Smith për kohën para se ai të emërohej në DHSK. Rrjedhimisht, në përputhje me rregullën 20(3) të Rregullores, Kryetarja e hedh poshtë menjëherë kërkesën si tërësisht të pabazë.

35. Duke qenë se kërkesa në lidhje me heqjen e gjykatësit Smith si gjykatës në këtë çështje është hedhur poshtë, pjesa e mbetur e kërkesës së Mbrojtjes⁴³ hidhet poshtë mbi bazën se nuk ka objekt shqyrtimi.

III. VENDIM

36. Për arsyet e lartpërmendura, Kryetarja:

- a) **VENDOS** të pranojë se dorëzimi i Kërkesës është bërë në përputhje me nenin 36(3) të Udhëzuesit të Punës;
- b) **I RIKUJTON** Mbrojtjes t’u përmbahet në të ardhmen kritereve të neneve 36(1) dhe (3) dhe 41 të Udhëzuesit të Punës;
- c) **HEDH POSHTË** Kërkesën në lidhje me vetëtërheqjen ose heqjen e Kryetares së DHSK-së nga ushtrimi i funksioneve gjyqësore dhe

⁴² Siç e pranon Mbrojtja, ata mbështeten në parashtrime të cilat “janë pretendime dhe nuk janë parashtruar si fakte të vërtetuara”. Shih Kërkesa, para. 90.

⁴³ Shih Kërkesa, para. 101(d)-(f).

administrative;

- d) **HEDH POSHTË** Kërkesën në lidhje me vetëtërheqjen ose heqjen e nënkryetarit mbi bazën se nuk ka objekt shqyrtimi;
- e) **HEDH POSHTË ME PROCEDURË TË SHKURTUAR** Kërkesën në lidhje me heqjen e gjykatësit Smith nga Trupi Gjykses II në këtë çështje gjyqësore;
- f) **HEDH POSHTË** pjesën e mbetur të Kërkesës të përshkruar në paragrafin 101(c) deri (f) të saj mbi bazën se nuk ka objekt shqyrtimi; dhe
- g) **URDHËRON** Mbrojtjen që deri më 23 gusht 2021, të dorëzojë një version të redaktuar publik të Kërkesës së korrigjuar (F00268/COR) dhe një version publik të Bashkimit (F00269) me këtë Kërkesë.

_____/nënshkrim/_____

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E premte, 6 gusht 2021
Në Hagë,
Holandë